



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

PROCESVERBAL

I

KONSULTIMIT PUBLIK

PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMEËM 2025-2027

Me datë 25.10.2024, në ambjentet e pallatit të kulturës “Hasan Prishtina”, u zhvillua takimi publik , me pjesëmarrje të banorëve, kryetarëve të fshtrave, përfaqësues të njësisë administrative, anëtarë të Këshillit Bashkiak dhe Kryetarit të Bashkisë Kukës.

Takimi hapet me fjalën e kryetarit të bashkisë Kukës z. Albert Halilaj, i cili falenderon pjesëmarrësit dhe prezanton para tyre prioritetet për PBA-në 2025-2027.

Konsultimi vijon me sugjerimet dhe kërkesat e pjesëmarrësve.

B.Shala: Kukësi vuan nga kriza e përfaqësimit. 31 anëtarët e këshillit bashkiak vijnë nga 18 subjekte politike. Do të flas sot për fshatin tim të origjinës. I jepet prioritet rrugës së Brekisë dhe anashkaloni Mamëzin. Vetëm nga Mamëzi buxheti i shtetit merr 70 milion euro. Duhet të parashikoni investime për këtë zonë që çn shumë të ardhura në buxhetin e shtetit.

A.H: Zona ka shumë problematika. Ministria e Infrastrukturës është zotuar të bëjë investime. Deri tani nuk është bërë. Loti I parë do të bëhet me të ardhurat e bashkisë.

A.G: Në lagjet 4 dhe 5 banorët kanë një shqetësim: makinat lëvizin me shpëjtësi. Nuk ka rampa për ta penguar këtë situatë. Duhet të bëhet një ndërhyrje këtu. Gjithashtu, kërkoj që në buxhetin e vitit 2025 të vecohet një fond për barazinë gjinore. Të bëhet ndricimi i rrugës te zabeli pasi shumë gra infermiere lëvizin në turnet e vona. Një pjesë e këtij fondi të vecohet për takime me gratë.

A.H: Mund të përdoret qendra NOK për takime të tilla.

S. K: Lidhur me hapjen e urës së re, pamë në listë të prioriteteve rehabilitimin e rrugës hyrëse te Radio Kukësi. A duhet ta lexojmë si hap pozitiv për mbajtjen e hyrjes së Kukësit te ura e vjetër?

A.H: Do të bëhet hyrje dytësore ku do të qarkullojnë banorët e fshatrave të Kukësit si dhe banorët e Hasit. Investimi do të bëhet nga ARRSH-ja.

B. H: Kërkoj organizimin e një maratone dhe do të insistojmë ta kthejmë në traditë. Kërkojmë mbështetje financiare. Për herë të parë do e provojmë në pranverë 2025. E kanë bërë edhe bashki të tjera.

S. M: Kemi prioritet

1. Grumbullimin e autobusëve dhe furgonëve.

2.Kur do fillojë të bëhet parkimi me pagesë në lagjet e rikonstruktura?

3.Pse nuk futen në kapital të bashkisë investimet në ujësjellës?

A.H: Do të propozoj që ish-Drejtoria e Kufirit të kthehet në terminal.

Lidhur me pagesat e parkimeve, do të fillojmë aplikimin e një tarife pasi të përfundojmë me sinjalistikën në qytet.

Në lidhje me investimet në ujësjellës, 7 fshatra nuk janë kaluar. Me një shkresë përcjellëse do ia kërkojmë këshillit bashkiak.

G. V: Rruga e Surrojit është në listë të prioriteteve të paktën 3 vite. Loti i parë nuk e prek Surrojin. Kur do të bëhet ky investim?

Shkolla e Cinamakës nuk ka parë asnjë investim. Nga zona jonë shteti merr rentë minerare dhe neve si komunitet nuk na kthehet asnjë investim.

Ka 30 vite që kur është bërë investimi i fundit në ujësjellësin Shtiqën. Duhet të ribëhen pasi janë të amortizuara. Gjithashtu, për 300 m tub një pjesë e fshatit Borje është pa ujë.

A.H:Loti i dytë i rrugës Mamëz-Surroj do t'i kërkohej Ministrisë së Infrastrukturës. Shkolla e Cinamakës nuk ka kapacitet të nxënësve prandaj nuk bëhet investim.

Për kanalizimet e ujërave të zeza në Kukës kemi një project 9.6 milion euro.

N. S: A ekziston mundësia që firmat të cilat ushtrojnë aktivitet minerar në zonën Mamë-Surroj-Arrën të investojnë qoftë dhe vetëm një km rrugë? 1 km e marr unë përsipër.

B.O: Kemi vënë re rritje të performancës. Mungon plani i menaxhimit të mbetjeve.

Do të sugjeroja që drejtoria e financës të përgatisë buxhetin për qytetarët. Gjithashtu, duhet të bëhet një regjistër për detyrimet e qytetarëve për mbetjet.

Të ngrihen strukturat komunitare në qytet.

Bashkia e Kukësit është bashki pilot. Do të bëhet një project në Përbreg. Është drejt finalizimit.

R.D: Rehabilitimi i rrugëve rurale, të bëhen turbine, kanale dhe most ë shkojmë në të njëjtën pikë direct pas investimit.

Shkollat janë qendra komunitare por nuk kanë mjete që të kryejnë aktivitete.

Vendosja e trampave në disa segmente rrugore në qytet është emergjente pasi situatë është shqetësuese.

N.R: Është bërë një ujësjellës në Mholaj dhe ende nuk është lidhur. Rruga e këtij fshati ka 2 mandate që është në prioritet dhe ende nuk është bërë. Kërkojmë të financohet në vitin 2025.

A.H: Drejtoria e Ujësjellësit të zgjidhë problemin brenda 1 jave. Lidhur me rrugën, premtoj që do e realizojmë në vitin 2025.

Banor i lagjes 6: Investimi që është bërë në lagjen tonë po shkatërrohet. A mund të bëjmë dicka për ta mbrojtur?

Policia bashkiake duhet të ushtrojë detyrën.

Banor i fshatit Ujmisht: Turizmi I Ri është kthyer në një vepër të turpshme.

Kërkohet ndërhyrje në njësitë administrative. Duhet të merren masa për zjarrvëniet. Kërkojmë investim në shkollat Ujmisht dhe Lusën.

A.H:Turizmi është në pronësi të Ministrisë së Financave. Kemi disa kërkesa për ta blerë.

Oxhaku I Uzinës është një object që e identifikon Kukësin. Kam kërkuar nga Fondi Shqiptar I Zhvillimit të investohet në këtë objekt.

Mbyllet takimi

Kukës, 25.10.2025

